

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

NACIONAL

Drejtor:
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com



Tropoja, vendi prej nga Shqipëria merr dritën

Poshtë maleve deri tek valët e një liqeni të stërgjatur për në Tropojë, rruga është një stërmundim i fortë për të prodhuar dritën. Tashmë pa legjenda, shtepitë e rralla me antena të vetmuara të kanaleve satelitore, tregojnë se përpjekja e këtij rajoni...

Nga Mujë Buçpapaj

faqe 2 dhe 16



Pse PD e meriton mandatin e dytë

Intervistë me Kryetarin e Shoqatës "8 Dhjetori 1990" Arben Gabraj

Gabraja: Jam optimist për fitoren e të djathtës. PD me ato që ka bere e meriton një mandat të dytë për të vazhduar reformat...

faqe 5

PUNË E MIRË KOSOVË

Presidenti i UDMR Marco Bela parashtroi një sistem autonomie të shtrirë dhe cilëson gjuhën hungareze si gjuhë zyrtare në rang lokal. Në raportin e tij Bela tha se të gjitha çështjet kontroverze duhen analizuar përpara se të plasi konflikti si në Moldavi, Kosovë etj

Nga Prof. Edgar Rafael

faqe 3

NJË AVOKAT PËR ÇAMËRINË...

Si ndodh rëndom në koalicionet e zyrtarizuara parashtrohet pyetja: "A është e besueshme Marrëveshja në planin politik? Sa mund të ndikojë ky koalicion në bashkëqeverisjen e ardhshme jo vetëm në të mirë të dy partive, por edhe në planin kombëtar?"

Nga Namik Selmani

faqe 4

MERITOKRACIA NË KOSOVË

Motoja: Neve nuk duhet të na interesojë se prej cilit rajon është dikush, por sa kush ka bërë për atdhe. Nëse dikush ka bërë shumë, të gjithë, pa dallime rajonale, duhet të jemi në mbështetje të tij. E, si po ndodhin mënjanimet e autoriteteve nga skena politike gjatë këtyre viteve në liri, një ditë vetëdija lokaliste Kosovën do ta sjellë në pozitë të vështirë.

Nga Nazmi Lukaj

faqe 4

"DENONCIMI" I ALEANCËS SË NATO-S

Shqipëria është anëtare e NATO-s. Një ëndërr që u bë realitet brenda një harku kohor relativisht të shkurtër. Mbështetja politike e publikut për këtë hap të vendit ka qenë e paprecedent: 98 përqind e popullsisë. Ja sepse e majta politike nuk ka guxuar të nxjerrë dhembët e të thotë jo. Frikë nga vota, nga opinioni publik.

Nga Arber Ahmetaj

faqe 4

Zgjedhjet në Shqipëri

Djathtizmi, garanci e zhvillimit

Nga Gani MEHMETAJ

faqe 3...



Bashkim Hoxha një Shkrimtarë postmodern

faqe 9

Intervista me këngëtarët e mirënjohur shqipëtarë

Gena : Kjo është jeta ime.

Vilma : Kam surpriza të tjera

Artan Shabani : Pse më pelqen Ledi.



Gena : Kjo është jeta ime.

faqe 23

Miss Qendra e Zvicres



Liridona Miftari :

Nuk jam akoma e dashuruar

faqe 13

Poezi nga: Selim Aliaj, Nezir Prokshi, Namik Selmani

faqe 19

Në BRENDESI

Kujtesë për një mik

Nga Besnik Mustafaj

faqe 7

Çmendoj unë për shqipëtarët

Nga Dr. Gëzim Alpion

faqe 12-13

Poezi Dashurie

Nga Zhak Prever

faqe 6

Media dhe politika liberale Amerikane.

Nga Gjekë Marinaj

faqe 21

Elegji për vllanë

Tregim nga Sami Repishti

faqe 18

Takimi letrar

Tregim nga Qazim Shehu

faqe 8

Arti i të shkruarit

Nga Ndue Ukaj

faqe 10-11

Proza bashkëkohore shqipe

Kritikë nga Fatimr Terziu dhe Miranda Haxhia

faqe 9-11

Poezi nga:

Feride Papeleka, Sejdi Berisha, Elisa Gjerani, Marjela Manga, Fatjona Geci, Ali Alidemaj etj.



Në foto Gjekë Marinaj

A e mbështet media amerikane politiken liberale?

Nga Gjekë Marinaj

A e mbështet media informative politiken liberale? Mbetet një pyetje aktuale e cila vështirë se gjen përgjigjen e duhur në favor të çdo amerikani. E larguar shumë nga standardet, pyetja e ka humbur lidhjen nga realiteti i paanshëm i problemeve. Për rrjedhojë kemi dy fjalë kyçe “konservatorë” dhe “liberalë” rreth të cilëve vërtet një dykuptimësi vërtetë pragmatiste që i ka ndarë analistët në dy grupe të mëdha kundërshtare. Ndaj me sa duket ka pak gjasa për t’u zgjidhur kjo çështje. Madje pyetja nuk parashtrahet me sensin e neutralitetit (për të mbajtur nën kontroll institucionet qendrore që mund të shihen si përgjegjëse në formimin e vlerave dhe kulturës qytetare.) Pyetja kërkon në veçanti, nëse gazetarët dhe prezantuesit radio televizivë informojnë dhe analizojnë në mbështetje të politikës liberale.

Një nga figurat e njohura në gazetari, Uiliam Mëkgowan (McGowan) i cili është gazetari i parë i revistës “*Newsweek International*” dhe radios BBC, me sa duket e tërheq pyetja ashtu sikurse parashtrahet. Ai thotë se “pa partishmëria për pjesën më të madhe të gazetarëve po i dorëzohet totalitarizmit të lirë, i cili mbështet programin social liberal (McGowan, 22).” Nga ana tjetër, Robert W. McChesney, profesor në Universitetin e Illinoisit në Rrafshinën Urbana, autor dhe redaktor i disa librave së bashku me John Bellamy Foster-in, gazetar, sociolog dhe eseist kundërshtojnë mendimin e McGowan-it me një nga tezat e fuqishme, duke thënë se “analistët konservatorë, ndërsa mbështeten në idenë partiake (tjeterjen e etikës profesionale të neutralitetit) si një nga fillimet e censurës së deklaruar nga media e majtë, e cila as që interesohet për mbrojtjen e gazetarisë së specializuar, por për eliminimin e saj, pra, për bashkëpunimin e panevojshëm prej atyre që e praktikojnë dhe e mbajnë përfundimisht nën kontroll median. (McChesney dhe Foster, 31).”

Me gjithë konsideratën e duhur mendoj se vlerësimet personale të tyre mbi këtë çështje janë të padrejta për të bërë të ditur rëndësinë e emrave të gazetarëve dhe profesionalizimin e tyre në lidhje me problemin, jo vetëm për gazetarët e palodhur dhe të ndershëm, por edhe për vendosmërinë e jashtëzakonshme të gazetarisë së specializuar si një e tërë. Nga sa është thënë, pasi kemi përmbledhur faktet kryesore të

nxjerra nga McGowan-i, McChesney-i dhe Foster-i, sipas vlerësimit të argumenteve dhe duke praktikuar disa prej këndvështrimeve të marra nga leximi im, eseja kërkon të sjellë prova se pjesa më e madhe e gazetarëve profesionistë janë në të njëjtën kohë militantë partie, të cilët jo vetëm që nuk informojnë dhe analizojnë zhvillimin e sukseseve të sotme sociale, por edhe synojnë t’i manipulojnë.

William McGowan nuk e sheh veten as si konservator, as si liberal, atij i pëlqen të quhet shkrimtar pragmatist i përkushtuar pas një përfaqësimi të hapur dhe të drejtë të fakteve, me mendësi të sinqertë, për polemika të ekuilibruara mbi tema të ndryshme dhe të njohura. Ndaj ia vlen të themi se është një nga dëshmitarët e gjallë të disa

an, 23).” Njëlloj si konservatorët nga të cilët zbulon se “informacioni i shtrëmbëruar bie ndesh me vlerat e tyre” po kështu McGowan “shqetësohet” për liberalët duke u thënë se edhe ata “duhet të shqetësohen për këtë gjë.” Me keqardhje shprehim se ndryshimi u kthye shumë shpejt në një nga problemet më të rëndësishme për shoqërinë dhe gazetarinë amerikane, e cila konsiderohet fajtorë për disa media në vend më tepër për “polarizimin, se sa ballkanizmin.” Sipas tij, pas një takimi me botuesit e gazetës American Society dhe Shoqatën e Gazetarisë Amerikane, në vitin 1992, “shumëllojshmëria u kthye në fenë e re dhe ai që synonte të bëhej dikush në botën e lajmit, do të duhej të mbështetej prej saj (McGowan, 23).” Por problemi sipas mendimit

ka ndryshuar për t’u pajtuar me kërkesat politike dhe fitimprurëse të pronarëve të medias dhe në përgjithësi të shoqërisë private (McChesney dhe Foster, 32).” Paditë e pakta në numër u drejtohen pjesës më të madhe të mbështetësve të rëndësishëm të gazetarisë së përfaqësuar nga Bill Kovack dhe Tom Rosenstiel. Padia më duket e padrejtë për dy arsye. Së pari, sepse paraqitet si devijim i gazetarëve nga betimi i bërë në fillimet e gazetarisë që i përket të vërtetës dhe vë në dyshim besnikërinë e tyre ndaj qytetarëve amerikanë. Së dyti, heq vëmendjen nga roli njerëzor që luajnë gazetarët në botë përmes ndryshimeve kulturore. Me kritikën e çështjes sipas sferës politike, McChesney dhe Foster-i i nxjerrin gazetarët profesionistë si viktima të

politikanëve, pronarëve dhe forcave të tjera të fuqishme në shoqëri. Përveç faktit se përplasja e tyre me qeveritarët dhe personalitetet e fuqishme konsiderohet si “burimi kryesor i ligjshëm për lajmin” deri diku është e vërtetë, pasi rruga e suksesit nuk do të merrret si dobësi profesionale e gazetarëve, por si realitet i pavarur amerikan. Pas të gjithave në një nga diskutimet e tij thuhet se, “gazetarët profesionistë zënë vendin e parë për drejtësi dhe paanshmëri sociale (McChesney dhe Foster, 30).”

Ata duhet të kuptojnë se shumica e gazetarëve merren me problemet, vlerat dhe ideale të inteligjencës qytetare. Zhvillimi i përgjithshëm social i vendit përbën barometrin e suksesit. Ata nuk frikësohen, por bëjnë gjithçka duhet, për të mbrojtur të drejtat e njeriut në shoqërinë tonë. “Frika nga etiketimi si racist apo fanatik e bën pjesën më të madhe të gazetarëve të bardhë ngurrues ndaj nxitjes për mbrojtjen e këtij informacioni”, kritikon McGowan-i (McGowan, 23). Në mënyrë ironike mbetet një prej diskutimeve që bie ndesh me tezat e tij. Nëse informacioni duhet të “nxitet”, çfarë do të thotë kjo për pjesën më të madhe të gazetarëve që punojnë atje, në lidhje me “fobinë ndaj një etiketimi të tillë...”? Ajo që po thuhet është se, ai

synon që gazetarët të ecin kundër organizatës amerikane për të drejtat civile për martesat midis emigrantëve legal dhe ilegalë” *Lambda Legal Defense*, e cila vërteton se martesa është një e drejtë civile që u përket atyre që janë të gatshëm t’ia përkushtojnë jetën plotësisht dashurisë dhe të mbështesin njëri – tjetrin. Për më tepër, ai kërkon një informacion që do të synojë të ndryshojë hapat pozitive të ndërmarra për të rritur përfaqësimin e grave dhe pakicave kombëtare në fushat e punësimit, shkollimit dhe bizneseve nga të cilat kanë qenë të përjashtuara për një kohë të gjatë. Ai gjithashtu do të kërkonte një opozitë gazetareske të fuqishme për të drejtat e emigrimit dhe lëvizjes femine. Por le të ndalemi pak këtu. Po ta llogarisim matematikisht duke lenë mënjanë emigrantët, njerëzit me ngjyrë dhe gratë, atëherë nga çfarë do të përbëhej shoqëria amerikane? E po mirë, Zoti na faltë, se përndryshe vendi do të përfaqësohej në botë nga: McGowan dhe Rush Limbaugh.

Si përfundim, gazetarët profesionistë amerikanë janë plotësisht në dijeni se media është një mekanizëm i rëndësishëm për asimilimin e shoqërisë dhe vendosjen e secilit në një rang më të lartë në shoqëri. Ata, jo vetëm që janë gazetarë, por janë edhe militantë të të drejtave të njeriut, të cilët gjithmonë përballë vendosjen me vështirësi, ndërsa informojnë rreth të vërtetave, qoftë duke i dhënë zgjidhje papunësisë apo burgosjes në Amerikë, ose rrëmbimit, apo vrasjes diku jashtë kufijve. Kjo nuk do të thotë se mbështesin politikën liberale. Por sepse i janë përkushtuar fuqishëm vetëm një çështjeje, me idenë se problemet sociale janë garanci për dhënien e lajmit pa politizime dhe me interesim të lartë, pasi roli i gazetarëve është i rëndësishëm për ndryshimin e tyre. Ata arrijnë të kuptojnë se shoqëria amerikane përbëhet nga disa grupe të ndryshme që sjellin vlera dhe ide të shumta për jetën sociale. Por në të njëjtën kohë bëjnë të njohur funksionimin e duhur të vlerave dhe ideve që kërkojnë nivele të caktuara të tolerancës dhe shumë më tepër marrëveshje reciproke. Ndaj kurrë nuk ndalin së mbështeturi vlerat e paqes, perceptimit dhe dashurisë për mbarë njerëzimin. Pikërisht, kjo i dallohen nga të tjerët si: McGowan, McChesney dhe Foster të cilët ose kërkojnë të etiketohen si komplotistë liberalë, ose si viktima të dobëta të politikanëve, pronarëve apo forcave të tjera të fuqishme.

Përktheu nga anglishtja:

Irena PAPINGJI



prej temave të larmishme me shumë rëndësi, me të cilat ndeshet vendi ynë si: emigrimi, racizmi, ligji për emigrantët, feminizmi dhe lëvizja militante. Kundërshtimi që ngre dhe qëndrimi që mban për këto probleme mund të shihen ende si shqetësim për lexuesin dhe padrejtësi për komunitetin e gazetarëve. Po të flasim me nota të larta pesimizmi, ai e konsideron gjeografinë kulturore të vendit me “ndryshimin në nivelin e fundit” dhe kjo do të mohonte plotësisht zhvillimin social që është ndërmarrë, veçanërisht për këta dhjetëvjeçarët e fundit. Veç kësaj në emër të “gamës së gjerë të nxjerrjes së informacionit, ku pjesa më e madhe janë kritikues” (d.m.th konservatorët), ai kërkon përgjigje për “ndryshimin kulturor” të cilin e quan “grupi i gazetarisë ambicioze (McGowan,

të tij ishte më i thellë se sa mund të duhej. Në një farë mënyre ai bashkon “median liberale” me antipatinë e tij për “përçarjen” kulturore dhe politike që “do të ndryshonte shumë shpejt demografikët e dalë nga shtimi i popullsisë së njerëzve me ngjyrë.” Më tej ai vazhdon me diskutimin se, emigrimi i popujve të Botës së Tretë lidhet me prirjen liberale për grupet etnike, traditat dhe gjinitë, “me nxitjen e luftës së hapur sipas kuptimit të identitetit mbarëkombëtar amerikan dhe vlerave të kombit, në paanshmëri me shoqërinë civile (McGowan, 24).”

Ndërkohë që Robert W. McChesney dhe John Bellamy Foster nuk e shohin gazetarinë e specializuar të përfshirë në planin liberal funksional ashtu si e konsideron McGowan, ata pretendojnë se strategjia profesionale po kufizohet dhe